



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 18
Prishtinë, 09 shtator 2008, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylja, Mimoza Ahmetaj, Bujar Bukoshi, Qamile Morina, Armend Zemaj dhe Teuta Hadri.

Munguan: Rita Hajzeraj dhe Sllobodan Petroviq.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj-administratore, Drita Morina – zyrtare e lartë ligjore, Fatime Qorri - zyrtare ligjore.

Nga NDI: Shefki Kastrati

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 3. Shqyrtimi i planit të punës të Komisionit,**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi - Konstatoi se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi - Konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i planit të punës të Komisionit

Sadik Idriz - Tha se disa çështje kanë mbetur pa u përfunduar edhe nga sesioni pranveror. Propozoi që grupi punës ta vazhdojë monitorimin e zbatimit të Ligjit për veprimtarinë private në shëndetësi. Po ashtu ai propozoi që në njërën nga mbledhjet e radhës të ftohet ministri i Shëndetësisë për të diskutuar për problemet në shëndetësi, për Ligjin për sigurime shëndetësore, për pagat e punëtorëve etj. I njoftoi anëtarët e Komisionit për rekomandimet e dorëzuara me shkrim nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, lidhur me implikimet buxhetore të Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Po ashtu tha se në procedurë është edhe Projektligji për të drejtat e ish-të burgosurve politikë. Komisioni do ta shqyrtojë këtë projektligj para leximit të parë në seancë. U hap diskutimi.

Gjynaze Syla -Tha se nëse ka ligje të tjera të fushëveprimtarisë së këtij komisioni që nuk janë nënshkruar nga PSSP-ja, duhet të përfshihen në planin e punës. Ajo propozoi që Komisioni, në njërën nga mbledhjet e ardhshme t'i ftojë për të dëgjuar përfaqësuesit e Trustit Pensional, për arsye se Komisioni i ka në fushëveprimtari të vet punën dhe mirëqenien sociale, prandaj duhet të ketë informata çka po ndodh me trust.

Nurishahe Hulaj - Tha se nga shtypi është informuar se në shtator do të mbahet një konferencë për Ligjin për sigurimet shëndetësore. Ishte e mendimit se Komisioni duhet të marrë pjesë në këtë konferencë. Sa i përket planit të punës, tha se, në radhë të parë, duhet të vlerësohet se deri ku ka arritur Komisioni me këtë plan dhe grupi i punës i Komisionit për monitorimin e Ligjit për veprimtarinë private në shëndetësi.

Ajo tha se ka ardhur koha që Komisioni të marrë nismë për ndryshimin e Ligjit për shëndetësi, sepse duhet të identifikohet puna e atyre që punojnë në sektorin privat dhe në sektorin publik. Këta dy resorë duhet të ndahen.

Armend Zemaj - Tha se e ka marrë një ftesë nga Ministria e Shëndetësisë për të marrë pjesë në një konferencë që mbahet në Estoni për sigurimet shëndetësore. Ministri i Shëndetësisë është i interesuar të ketë takim paraprak me Komisionin e shëndetësisë, pasi që Ministria e Shëndetësisë është e interesuar që këtë ligj ta procedojë sa më parë.

Qamile Morina - Kryesuese e grupit të punës për monitorimin e Ligjit për veprimtarinë private në shëndetësi – tha se grupi punës do ta vazhdojë punën e filluar në sesionin pranveror. Ajo që e shqetëson atë më shumë është gjendja e rëndë në shëndetësi. Situata në terren është alarmante. Ajo propozoi që Komisioni, pasi ta dëgjojë ministrin e Shëndetësisë, ta vizitojë edhe QKUK-në, në mënyrë që Komisioni ta ketë një pasqyrë të qartë të gjendjes. Lidhur me propozimin për nismën e procedurës së ndryshimit të Ligjit të shëndetësisë, tha se ky ligj është shumë i mirë dhe mbi baza evropiane, por problemi është se nuk është zbatuar kurrë. Ligji i shëndetësisë, njerëzve kreativë, ua

mundëson punën edhe në institucione publike edhe në ato private. Kjo çështje duhet të debatohet dhe të gjendet një rrugë.

Teuta Hadri - Tha se gjendja në shëndetësi është shumë e rëndë. Problemi që ekziston në mes të ministrit të shëndetësisë dhe drejtorit të QKUK-së duhet të zgjidhet. Njëri nga këta të dy duhet të tërhiqet. Ajo që komisioni mund të bëjë lidhur me gjendjen në QKUK, është të marrë një qëndrim të cilin duhet ta paraqesë në seancë, sepse për këtë çështje duhet të zhvillohet debat në seance plenare.

Sadik Idriz – Tha se në seancë plenare, secili deputet, anëtarë i këtij Komisioni, mund ta paraqesë qëndrimin e subjektit të vet politik. Komisioni e ka për detyrë jo të ngrejë çështje, por të marrë qëndrim dhe ta propozojë atë në seancë plenare. Sa i përket propozimit për nismën e procedurës së ndryshimit të Ligjit të shëndetësisë, tha se kjo ka qenë nismë e kahershme, por ka dilema, sepse sektori publik do të mbetet pa mjekë specializant, ngase pagesat janë të ulëta dhe secili do të punonte në sektorin privat. Nismën për ndryshimin e këtij ligji mund të marrë si Qeveria ashtu edhe Komisioni.

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Në mbledhjen e radhës të ftohet për t'u dëgjuar ministri i Shëndetësisë.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Sadik Idriz